

INTERNATIONAL **BODY PSYCHOTHERAPY** JOURNAL

The Art and Science of Somatic Praxis

Published by the European and United States Associations for Body Psychotherapy and Somatic Psychology

Vajzat e Zeza mësohen të mbijetojnë: Trauma historike dhe mishërimi i gruas së fortë *Donya Wallace, Chanta Presley Moore, Karen Roller*

Autorët eksplorojnë origjinën e personalitetit të Gruas së Zezë dhe të Fortë përmes një lente historike të informuar nga trauma për të artikuluar arketipin si një përgjigje të parashikueshme dhe të nevojshme traume, duke analizuar domosdoshmërinë e forcës dhe transmetimin e saj brez pas brezi si dëshmi e përgjigjes së traumës stërgjyshore. Ne trajtojmë zhvillimin e traumës të shfaqur nga mishërimi i gruas së zezë të fortë, ashtu edhe efektet e dëmshme që ajo sjell. Ne i bëjmë thirrje të gjithë praktikuesve somatikë që të kërkojnë trajnime të vazhdueshme në qasjet anti-raciste për të siguruar shërbime terapeutike të aftë për klientët që shfaqin arketipin e Gruas së Zezë të Fortë dhe për studiuesit somatikë që të zhvillojnë vlerësimet dhe ndërhyrjet e praktikave më të mira.

Një kërkim anti-shtypës për të mbajtur një trup

Florie St. Aime

Kjo ese është vetë-reflektim mbi mishërimin e shtypjes dhe dëshirën kolektive për çlirim nga sistemet shtypëse, e njohur edhe si praktika e anti-shtypjes. Autorja ndan përpjekjet e saj të vazhdueshme për t'u përballur me de-kolonizimin duke e lehtësuar atë proces për ata që u shërben drejtpërdrejt dhe indirekt. Ndërsa nderon traditat e urtësisë jashtë kompleksit industrial të shëndetit mendor, ajo e fton lexuesin të çmësojë paradigmat e kontrollit të dhunshëm që synojnë të pretendojnë mendjet tona trupore nën maskën e rregullimit të tyre, për t'i dhënë jetë në vend shërimit tonë dhe për t'u krijuar hapësirë atyre që ne. shërbejnë për të bërë të njëjtën gjë.

Shtypja dhe varësia thyejnë familjet: Thirrja e praktikuesve somatikë për të riparuar lidhjen

Rachel Jacoby, Karen Roller

Ky artikull shqyrton literaturën në lidhje me përfaqësimin joproportional të fëmijëve me ngjyrë, indigjenë dhe njerëz të tjerë të rritur në kulturën e sistemit nën kujdestari sociale. Artikulli trajtonë rolin e paragjykit në referimet e bëra në Shërbimet e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe e vendosim atë paragjykim në sistemet më të mëdha të shtypjes traumatike që formojnë këndvështrimet e profesionistëve referues dhe shkatërrojnë sistematikisht familjet që janë të shtypura në margjinat e shoqërisë, duke rritur rrezikun e tyre për referim. Ne eksplorojmë rolin e varësisë si një përgjigje e zakonshme e traumës dhe etiologji e implikuar në përfshirjen e kujdesit birësues dhe pyesim se si familjet ndëshkohen në mënyrë të padrejtë për të. Së fundi, ne u bëjmë thirrje praktikuesve somatikë anti-shtypës të informuar për traumën për të ndihmuar në thyerjen e cikleve të varësisë, lidhjes së pasigurt, përfshirjes në sistemin e kujdesit birësues dhe lodhjes së dhembshurisë për ata që janë në llogoret e tij.

Nga mjegulla në ndërgjegje: Një model i ndërgjegjësimit të birësuesve

Susan F. Branco, JaeRan Kim, Grace Newton, Stephanie Kripa Cooper-Lewter, Paula O'Loughlin

Modelet e ndërgjegjes kritike ndriçojnë proceset me anë të të cilave grupet e marginalizuara zhvillojnë ndërgjegjësimin, si individualisht ashtu edhe kolektivisht, për sistemet dhe strukturat shtypëse në mënyrë që përfundimisht të angazhohen në aktivizmin për drejtësi sociale. Një grup i marginalizuar, të birësuarit, janë mbështetur në gjuhën "jashtë mjegullës" për të përcaktuar ndërgjegjësimin e të birësuarve urgjent për ndikimin e birësimit për të përfshirë praktikatat problematike sistematike. Modeli i ndërgjegjes së të birësuarve, i modeluar nga procesi *conocimiento* i Anzaldúa-s, shkon përtej vetëdijes emergjente për të përshkruar lëvizjen e vazhdueshme individuale dhe kolektive drejt aktivizmit shoqëror që të adoptuarit mund të hasin gjatë gjithë jetës së tyre. Modeli është konceptuar me pesë shtylla provash brenda spirales: 1) status quo, 2) shkputja, 3) disonanca, 4) shtrirja dhe 5) falja dhe aktivizim. Modeli merr në konsideratë ndërthurjen e identiteteve racore, etnike dhe kulturore, ndërkohë që promovon ndjeshmërinë për të birësuarit kudo që ata janë në spiralen e ndërgjegjes së të birësuarve dhe informon terapistë gjithëpërfshirës të trupit që punojnë me nevojat somatike të të birësuarve.

Translated by: Elmedina Çesko

Akti i zhdukjes: Mishërimi i Kufizuara dhe Përumbja e Modelit Biopsikosocial të Dhimbjes Kronike

Anna s. Kunin

Dhimbjet kronike, sëmundjet dhe aftësia e kufizuara janë fenomene të përhapura. Modeli biopsikosocial i dhimbjes është miratuar gjerësisht si paradigma mbizotëruese për të kuptuar dhimbjen kronike në fushat psikologjike dhe mjekësore. Megjithatë, forcat kapitaliste neoliberale e kanë drejtuar zbatimin e këtij modeli në mënyra që reduktojnë etiologjinë komplekse të dhimbjes kronike në faktorë individualë psikologjikë dhe të sjelljes. Kjo në mënyrë efektive zhduk përvojën somatike të njerëzve të sëmurë/të paaftë dhe pengon dëmin biologjik, psikologjik, social dhe sistematik të aftësisë. Ky punim ofron një perspektivë mbi dhimbjen kronike nga një paaftësi i vrojtimit të drejtësisë, duke paraqitur rrezikun e jetës dhe nxit mundësin e vdekjes (veçanërisht gjatë epokës së pandemisë). Artikulli eksploron si kufizimet ashtu edhe potencialin e somatikëve për të mbështetur ndjenjën e ndërmjetësimit të klientit brenda përvojës së tyre të dhimbjes kronike. Kjo, njëkohësisht është një përkujtim, një thirrje për reflektim dhe veprim nga ana e mjekëve, si dhe një kërkim mbi potencialin çlirues të mishërimit të sëmurë/të paaftë në kontejnerin terapeutik dhe më gjerë.

Praktikat Somatike në Supervizime Globale të Bazuar në Katastrofa: Prirje ndaj Traumës së Përbashkët dhe Rimëkëmbjes

Juanita Barnett, Elizabeth Louis, Karen Roller

Ky artikull rishikues shqyrton literaturën mbi supervizimin global në mjediset pas katastrofës. Ai zbulon një boshllëk rreth praktikave specifike të mishërimit të reagimeve -kulturore që mund të konsiderohen si praktikat më të mira për supervizime efektive në mjediset pas katastrofës. Autorët reflektojnë mbi modelet e traumës dhe praktikat somatike të përdorura nga ekipi i tyre në supervizimet pas katastrofës për të parandaluar përjetimin e traumatizimit dhe dhembshurinë ndaj lodhjes, si dhe ofronë sugjerime për kërkime të mëtejshme.

Puna me zë dhe shërimi me zë: Tejkalimi i përgjigjes me heshtje dhe mosmësimi i heshtjes
Nicole Cowans, Karen Roller

Ky artikull rishikues përshkruan harmonin teorike dhe praktike midis punës me zë, Shërimit Integral të Tingullit dhe praktikave somatike të studiuara tradicionalisht. Ai nxjerr në pah vlerën e përpunimit të traumës dhe fuqizimit të punës së strukturuar me zë për të rikthyer zërin e dikujt nga heshtja sistematike prej strukturave dhe individëve shtypës. Autorët propozojnë punën me zë dhe shërimin integral të zërit si të rëndësishme për t'u përfshirë në psikoterapi somatike për të mbështetur klientët në zgjidhjen e heshtjes sistematike dhe vetë-pohimit.

Neo-funksionalizmi i aplikuar në përvojën e jetuar të një personi transgjinor gjatë afirmimit

Letizia Sturiale, Roberta Rosin, Irene Leo

Njerëzit transgjinorë mishërojnë dhe shprehin një identitet gjinor që i kapërcen pritshmëritë sociokulturore për gjininë që është e lidhur tradicionalisht me gjinitë biologjike binare. Ekzistojnë forma të patologjizimit dhe mjekimit të fenomenit transgjinor në lidhje me procedurat ligjore, si dhe në praktikën mjekësore dhe psikologjike, ku një këndvështrim binar i gjinisë vazhdon. Përqendrimi në mbështetjen psikologjike përpara se të fillohet ndonjë ndërhyrje hormonale dhe/ose kirurgjikale është një fazë delikate dhe shpesh e debatuese gjatë afirmimit të gjinisë. Qëllimi i këtij punimi është të paraqes një lexim të përvojës së jetuar të një personi transgjinor sipas modelit psikologjik të Funksionalizmit Modern. Nëpërmjet analizës tematike, u identifikuan temat domethënëse që formësuan këtë përvojë. Në përgjithësi, qasja neo-funksionale na mundësoj të ilustrojmë një perspektivë të realitetit transgjinor që synon të kapërcejë një pikëpamje dikotomike të trupit dhe mendjes duke iu qasur personit në tërësinë e tij. Në këtë mënyrë, supozojmë se janë minimizuar efektet kufizuese të konceptualizimit gjinor patologjik, mjeksor dhe binar. Së fundmi, janë diskutuar rezultatet e analizës së të dhënave dhe u siguroa mbështetje me literaturën përkatëse shkencore.

Përvoja somatike e mikroagresioneve në hapësirën terapeutike: Kuptimi i shkëputjes dhe rruga drejt riparimit

Shreya Vaishnav, Dareen Basma

Ky dorëshkrim eksploron përvojat somatike të mikroagresioneve, të kuptuarit e shkëputjes si rezultat dhe mënyrat për të riparuar këtë këputje në mjediset terapeutike. Autorët hulumtojnë procesin e somatizimit në lidhje me mikroagresionet përmes një studim rasti të detajuar. Për më tepër, ata theksojnë manifestimet fizike të këtij somatizimi dhe propozojnë ndërhyrje somatike që synojnë të rivendosin harmoninë në lidhjet rastësishëm të mishëruara të një individi.

Vizioni Fanon për racizmin e mishëruar për teorinë dhe praktikën psikoanalitike

Kenyona Young

Vizioni i Fanon-it për racizmin e mishëruar për teorinë dhe praktikën psikoanalitike është një vetë-eksplorim i qetësimin si një mbrojtje e trupit që lëviz përtej binarës në nënvetëdije dhe paravetëdijen, duke shkuar akoma më tej në strukturën e kastës amerikane. Studiues si Fanon, Hardy dhe Knoblauch eksploran me guxim se si strukturat hierarkale të racës dhe racizmit jetojnë në intersticionin tonë. Në këtë mënyrë, ne të gjithë duhet të ekzaminojm veten dhe se si kemi qenë bashkëfjatorë në sistemet e shtypjes dhe jemi subjekt i një ideologjie të bardhë. Ky vetë-ekzaminim fillon me ndërprerjen e modeleve të qetësimin dhe dekretimit.